




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambley

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04 Nr. MA-31110 /2016
Kaçanik, 09.09.2016

Në bazë të nenit 5 pika(c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit të punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015 Për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta të Komunës së Kaçanikut për vitin shkollor 2016/2017.

1. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Emin Duraku” në Kaçanik:

• **Paralelja e ndarë fizike në Gjurgjedell:**
Dy mësimdhënës të mësimit klasor me klasë të kombinuara.

2. Qendra për Edukim dhe Arsim Parashkollor “Agimi” Kaçanik:

Një Motër Edukatore.

3. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Ali Asllani” në Doganaj:

Një mësimdhënës i lëndës Gjuhë Angleze, me 6 orë, paralelja e ndarë fizike në Sllatinë.

4. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Jusuf Gërvalla” në Biçec:

Një mësimdhënës i lëndës zgjedhore Aftësi për Jetë, me kohë të caktuar.

5. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Dituria” në Ivajë:

Një mësimdhënës i Mësimit Klasor, dhe
Dy mësimdhënës për Mësim Klasor me klasë të kombinuara, paralelja e ndarë fizike në Strazhë.

6. Shkolla e Mesme Profesionale “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”-Kaçanik:

Një mësimdhënës i lëndës Matematikë me 18 orë, dhe
Një mësimdhënës i lëndës Gjeografi me 11 orë, me kohë të caktuar.

Kushtet e Konkursit:

Për vendet e punës të shënuar më lartë, kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it .Nr.06/2015 Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm . Kandidatët të cilët aplikojnë për këto vende pune, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, duhet ti plotësojnë edhe kushtet e veçanta: diploma e fakultetit përkatës, certifikata e lindjes, kopjen e letërnjoftimit, dëshmi mbi përvojën e punës në arsim, dhe certifikata të trajnimeve të akredituara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi në konkurs kanë kandidatët e degës përkatëse.

Të gjitha dokumentet gjatë aplikimit duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen , ndërsa origjinalin duhet ta sjellin në ditën e intervistimit .

Nëse kandidati aplikon në më shumë se një pozitë/institucion, ftohet në intervistë vetëm në shkollën /institucionin me prioritet të parë.

Afati dhe mënyra aplikimit.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimores-Zyra e Pranimit, kati përdhes.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes tabelës së shpalljeve publike.

Konkursi mbete i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik prej 10.09.2016 deri 24.09.2016.

